

Mehmet Halimi

FUNKSIONI ARTISTIK I KOMPOZITAVE NË KËNGËT E DASHURISË

Në këngët e dashurisë, përveç leksikut të zgjedhur nga gurra popullore, figurave stilistike e tropeve, ndeshim bukur dendur edhe kompozitat, që i japin shije vargut dhe e fuqizojnë artistikisht.

Kompozitat popullore janë komponentë e rëndësishme në pasurimin e gjuhës së shkruar. Këto japin mundësi të gjera për të shprehur nuanca kuptimore shumë të holla e me shije gjuhësore të spikatur. Këto janë „si rezultat i lidhjeve të shumëllojshme, në të cilat hyjnë pjesët e kompozitës, del një njësi e re leksikore që shpreh një nocion të ri”.¹

Ndërkaq, Kostaq Cipo, kompozitat i quan — „miklime e lulëzime të gjuhës, që marrin nga një emër sipas punës që bëjnë në gji të periodës”.²

Ne këtu kemi marrë për objekt spikatjen e bashkëjetesës dhe të mishërimit të kompozitave në një pjesë të krijimtarisë sonë gojore, madje duke veçuar pikërisht ato të blenit *Këngë dashurie I*. Shikuar nga aspekti i shtrirjes gjeografike, kompozitat e blenit në fjalë, jo vetëm që i gjejmë të përhapura në të gjitha trevat dialektore nga njëra anë, por vijimisht ndeshim synimin e pasurimit me kompozime të reja të folklorit tonë, nga ana tjetër.

Poeti popullor duke përdorur kompozitat me veçanti gjuhësore, me mjeshtëri e shije të hollë artistike, arrin të shprehë ndjenjën e sinqertë të dashurisë në vargjet e lirikës popullore. Këto kompozita që shprehin ndjenjat e ngrohta të dy të rinjve midis dy gjinive, lindin krahas procesit evolutiv të pasurimit të mjeteve të gjuhës dhe të vargut lirik, nga ana tjetër.

Pra, në këtë punim po veçojmë disa fjalëformime kompozitore që i kemi vjelë nga bleni *Këngë dashurie I*, i botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, duke vënë, njëkohësisht në spikamë mjeshtërinë dhe shijen e përdorimit, hijeshinë, bukurinë e madhështinë e gjallërimit të tyre në vargjet e këngëve tona të dashurisë.

¹ A. Kostallari, *Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë 1972, 83.

² Kostaq Cipo, *Rreth disa kompozitave*, *Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972, 61.

Kompozitat e kuptimësojnë edhe më tej fjalën, e thellojnë dhe e zgjerojnë atë, e pasurojnë gjuhën me njësi të reja leksikore, ndërsa përdorimi i tyre e fuqizon artistikisht vargun lirik.

Kompozitat janë kuptime të kondensuara, duke shprehur sintezën kuptimore të dy fjalëve, dy gjymtyrëve përbërëse, e fuqizojnë fjalën, vargut i japin shije dhe përsosmëri artistike.

Fjalët përbërëse në kompozita janë të qarta si nga kuptimet e tyre të parme, ashtu edhe nga kuptimi i tyre i ri që marrin në kompozimin përkatës. Kjo qartësi vërehet si në stilin e përditshëm bisedor, ashtu edhe më të qarta e më të mishëruara i ndeshim në funksion të vargut lirik.

Për të dëshmuar për funksionin artistik të kompozitave, për përdorimin e tyre, po i japim ato duke bërë jetë reale në vargjet e lirikës popullore:

*O moj shamejkuqe,
o moj shamejverdhe,
Dil ke kapixhiku,
Të folim njiherë,
Posi qera herë!*³

Po edhe vargjet:

*„Mori e mirë, jatak bogjake,
Ë mirë ke, e keq u plake”*⁴

Kompozitat në këtë ble i ndeshim në funksion të përshkrimit të bukurisë së femrës që fillon nga pamja e jashtme siç janë shamia, flokët, vetullat, sytë, faqet, goja, mjekrra, qafa, krahët, beli, vithet, këmbët, e deri te bukuria shpirtërore siç janë qëndrimi madhështor i bukurisë, krenaria, nazet, eleganca që janë pjesë e bukurisë së ambientit blegtoral e bujqësor.

Në vargjet e mëposhtme shquhet bukuria e flokëve:

*Del syzeza n'derë t'oborrit,
Zylyfzezë si krahi korbit
— Qysh p'e lamë punën e jorokut?
— Qysh a kanë gjith para sodit*⁵

Këngëtari popullor veçon bukurinë e flokëve si nga ngjyra e natyrshme nga njëra anë, po ashtu edhe nga rregullimi sipas shijes së vetë femrës nga ana tjetër, ai gjen përshkrime dhe vargje të ngrohta për secilin rast, duke dalluar tiparet e bukurisë së femrës, shpesh përdor kompozitat si elemente të fuqishme shprehëse.

³ Rrustem Berisha — Myzafere Mustafa: *Këngë dashurie I*, botuar nga Instituti Albanologjik, Pristinë 1979, 37.

⁴ *Po aty*, f. 83.

⁵ *Po aty*, f. 17.

Ja për shembull për hir të kompozitës *zylyfshkurta* me të cilën shpreh bukurinë e flokëve të gruas, poeti popullor përt t'i dhënë fuqi së madhërishmes përdor pesë vargje në shërbim të saj:

*Hajt, bre dadë, dert mos ki,
Pse baj manxerre e allti,
S'e la zjarmin pa ja u shti!
Kur t'avitet zjarmi tu kulla,
Djerget shkallëve zylyfshkurta⁶*

Gjithashtu kompozitat *vetullgalë*, *vetullhollë*, *vetullgjylpanë*, *vetullkalem* janë të shpeshta në vargjet erotike:

*Mori e mirë vetullgalë,
Qysh s'mi kajte kurr' dy fjalë,
Me t'ndie sa t'jam gjallë,
Kur të des, mos t'kofsha falë;⁷*

Për të qenë edhe më konkret, këngëtari popullor shpesh në përshkrimin e bukurisë së pjesëve trupore të femrës i drejtohet asaj me emër të caktuar, siç vepron në këto vargje:

*Moj Nasibe, vetullhollë,
Ku ke kjen-e, a m'je lodhë?
— Me gjergjef kam kjenë n'shkollë⁸*

Madje, bukurisë së femrës së caktuar, ia shton edhe një element tjetër të vlerës mendore, sepse pos bukurisë që ia ka dhuruar natyra, Nasibja është edhe shkollare.

Këngëtari popullor, sikur s'është kënaqur me përdorimin e kompozitës *vetullhollë*, sepse mendon se në një rast tjetër ajo nuk e shpreh bukurinë e vetullave të femrës në shkallën absolute, ndaj, është përpjekur që me mjete gjuhësore të gjejë sinoniminë e saj *vetullgjylpanë*, që për dukën e saj ndeshim një anatemë:

*Moj syzezë, vetullgjylpanë,
Lum'yt at, lumja jot'amë,
Ma lum çuni, qi t'ka zanë,
Mjer't jaranat qi ke lanë!⁹*

Për ta cilësuar edhe më mirë bukurinë e vetullave të femrës, poeti popullor ka krijuar kompozitën *vetullkaleme*:

⁶ *Po aty*, f. 260.

⁷ *Po aty*, f. 186.

⁸ *Po aty*, f. 187.

⁹ *Po aty*, f. 372.

*Aleme, vetullkaleme,
Ti u sjedhsh ka'dera eme;
U bëshë reja e nanës teme
Gatosh bukë në magjen teme¹⁰*

Me anë të kompozitave: *faqekuqe, faqeshurta, faqebardha*, spikatet bukuria e një pjese të caktuar trupore:

*Rrezon hana lugje m'lugje,
Çilma derën, moj faqekuqe!
Faqekuqe, qafëbardhanë,
Kah po m'shkon, si kerr me sanë,
Po të dridhet toka ner kamë,
Tana shoqet-o po t'kanë ranë¹¹*

Koncepti i shijes artistike të popullit tonë hetohet në dëshirën që femra të jetë e shëndoshë, e pastër, e bardhë e fytyrërrumbullake, e mbushur nga shëndeti, tipar të cilin e ka shprehur me kompozitën përkatëse *faqeshkurtna*:

*Çajo faqeshkurtna, moj
Zembrën ta këputka,
Sëit me lot t'i mbushka¹²*

Kultura e mirësjelljes, edukata, zemërbutësia e femrës dhe simpatia ndaj saj, shprehet me kompozita: *gojëmjalta, gojëbuta, gojëshiqere*, që janë tipare të femrës së urtë, të qetë e të njerëzishme.

*N'ato pinxheret e nalta,
Del Mereme gojëmjalta.
N'ato pinxheret e ulta,
Del Mereme gojëbuta¹³*

Ideali i poetit popullor për femrën e bukur nuk qëndron vetëm në fjalët e saj të ëmbla, por, përveç kësaj, ai kërkon që ajo të ketë shëndet të mirë dhe bukuri fizike:

*Gojëshiqere dh'am'dukate,
Kam të trasha, trapullake,
Shtat të hollë për marak-e,
Ma ke plasun zemren n'bark-e!¹⁴*

Në lirikën e dashurisë nuk ndeshim vetëm këngë që i janë kushtuar femrës nga mashkulli, por edhe anasjelltas, kur femrat i kë-

¹⁰ *Po aty*, f. 124.

¹¹ *Po aty*, f. 113.

¹² *Po aty*, f. 148.

¹³ *Po aty*, f. 34.

¹⁴ *Po aty*, f. 237.

ndojnë mashkujve, duke madhëruar bukurinë e tyre trupore dhe tiparet burrërore; pranë të cilave vërehet simpatia për të dashurin dhe antipatia për atë që përbuz:

— *Pse me dekë un' djalë, me ty,
Tue pasë burrin djalë t'ri,
Kallushan musteqezi,
Katunar, veshun si zotni,
Kagatar në shtat nahi.*¹⁵

Kompozita e përdorur në këto vargje ka kompletuar tiparet e burrit me bukurinë e mustakëve nga njëra anë, duke e harmonizuar me veçoritë burrërore, shoqërohet edhe me tipare të tjera që e portretizojnë dhe e kompletojnë personazhin e adhuruar nga femra, siç janë: *kallushan, i veshur si zotni*, e mbi të gjitha ai është edhe *këngëtar më i mirë i shtatë nahive*.

Në vargjet:

*Mor e mira mjekërrbutë,
Thep në thep po kcen si sutë,
Thep në thep po kcen si zanë,
Flokt e g-jata pse i ke lanë?*¹⁶

dëshmojnë e femra në fjalë, pos bukurisë trupore, që ia ka dhuruar natyra, është edhe e shkathët, e shpejtë dhe e aftë për të kryer edhe punë të shtëpisë pa pritesë.

Kompozitat në vargjet e erotikës popullore mund të marrin nuanca të ndryshme kuptimore, që drejtohen nga dëshira e atij që i përdor:

*O kadi, o mjekërrzi,
Shih sherjatin, si di ti,
A asht plaka për djal' t'ri?*¹⁷

Kompozita *mjekërrzi*, shpreh nga njëra anë cilësinë e mjekërrës, njeriun e shtresës së caktuar shoqërore gjëja me seriozitetin e tij, por në thelbin e kësaj kompozite ndeshim edhe një dozë humori e ironie për njerëzit e fesë dhe ligjet e klasës sunduese.

Nuk ka pjesë trupore të femrës për bukurinë e së cilës të mos jenë përdorur dendur kompozitat si elemente të veçantisë gjuhësore të poetikës popullore, të cilat shtojnë përjetimet: *qafëbardhanë, ballagushja, qafëgastare*, me të cilat përshkruhet bukuria e qafës së femrës:

¹⁵ *Po aty*, f. 157.

¹⁶ *Po aty*, f. 26.

¹⁷ *Po aty*, f. 104.

O ballagushja e nanës,
 O qafëbardhana e nanës,
 O ti je për marak-e,
 O nana t'ka bajrak-e¹⁸

Vargjet e mësipërme, për dallim nga vargjet e deritanishme, shprehin gëzimin dhe ndjenjën intime prindërore të nënës ndaj bukurisë së bijës në mënyrë direkte, ndërsa në mënyrë të tërthortë edhe simpatinë e rrethit dhe të ambientit të saj të shprehur nëpërmjet gojës së poetit popullor.

Kompozitat e veçara më lart gjejnë zbatim artistik edhe në këto vargje: „Façekuqe, qafëbardhanë / Kah po shkon si kerr me sanë”¹⁹ / dhe:

Mori e mira qafgastare,
 Me t'u lutë po m'vjen marre,
 Pa t'u lutë, nuk po kam qare.²⁰

Në tërë blenin në fjalë, në të gjitha këngët e dashurisë nuk mbetet pjesë e trupit të femrës pa u përshkruar nga poeti popullor, ndaj në të gjitha këto përshkrime më mikluese janë lulëzimet gjuhësore të shprehura me anë kompozitash. Këtu do të zëmë ngoje disa nga kompozitat që janë në shërbim të përshkrimit të supeve e gjoksit të femrës si qenie shoqërore, të cilat shquajnë bukurinë dhe zhvillimin harmonik të këtyre gjymtyrëve në proporcion me bukurinë e tërësishme trupore:

Mori çikë krahadalldyshë,
 Kur t'i pash' cicat nën kmishë,
 Kam hap kraht ngryk me ta ngjit;
 Me ta shti rrethin n'gisht²¹

Apo edhe në vargjet: „Kur e ke-o krahgjanën-o / Edhe e han si manën-o”²² / .

Shija estetike për belin e vajzës apo të gruas është shprehur fuqishëm me kompozitat: *përmjet-hollë*, *belhollë*, *mjedis-hollë*, *kryq-hollë*, *etj.* Sa të qëlluara janë në aspektin gjuhësor, aq më funksionale paraqiten nga aspekti artistik i përsosurisë së vargjeve lirike:

Vetullhollë, tybe gajtanli-e,
 Përmjet-hollë, ore për shami-e,
 Vithegjanë, tybe për dimi-e,
 Lumi un-o qi t'kam kojshi-e²³

¹⁸ *Po aty*, f. 110.

¹⁹ *Po aty*, f. 113.

²⁰ *Po aty*, f. 135.

²¹ *Po aty*, f. 365.

²² *Po aty*, f. 117.

²³ *Po aty*, f. 332.

Bukuria e *përmjet-hollës* në një rast tjetër është shprehur me kompozitën sinonimike të saj me *belhollën*. Edhe pse këto kompozita sinonimike duken identike si njësi të lira leksikore, në kontekst vargësh lirike sjellin përshtypje dhe disponime estetike të ndryshme:

*Fleta lëshoj lule,
Lulja bëri mollë,
Ta ha me bandille,
Me at belhollë²⁴*

Po kështu edhe pse kompozita sinonimike e *belhollës* është *mjedis-holla*, në një kontekst të caktuar, në një ambient tjetër dhe në një të folme dialektore krejtësisht tjetër, ofron ngrohtësi e intimitet lirik krejtësisht të ri:

*Coucë, coucë, mjedis-hollë,
Dil ke çeshmja, nër kësollë!
Koush i pret, i thaftë një dorë!
I thaft' një dorë, i thaft' një kamë!
Janë të bukra për t'i ngranë;²⁵*

Sa funksionale janë kompozitat dhe sa përdorim të dendur gjejnë në blenin e *Këngëve të dashurisë*, përveç shembujve të shumtë që sollëm deri tani, dëshmojnë edhe këto vargje më poshtë:

*Mori e mira qysh duhet me kanëë,
Holl' përmjetin, mori vith egjanë,
Lumi burri-o qi t'ka zanë,
Mjer jaranat-o ku i ke lanë.²⁶*

Apo „Moj mollkuqe, shka m'ki n'gji? / Kam dy shishe me ki /.²⁷

Me anë të kompozitës *kryeungjur* shprehet modestia e femrës dhe matura e turpi në të ecur, që e bën atë edhe më të dashur, më të afërt e më simpatike për mentalitetin e popullit tonë:

*Me ka nënëja një të bukur,
Kur shkoj udhës, moj kryeungjur,
Kryeungjur unë kur shkova,
As me një, moj me gojë nuk fola.²⁸*

²⁴ *Po aty*, f. 323.

²⁵ *Po aty*, f. 144.

²⁶ *Po aty*, f. 371.

²⁷ *Po aty*, f. 51.

²⁸ *Po aty*, f. 94.

Ndërkaq kompozita *jetimzeza* në vargjet e mëposhtme shpreh përvujtërinë e dashnorit:

*Jetimzeza, çka po lypë?
Ni kashat' bukë, 'i kokërr krypë.*²⁹

Ndërsa kompozita *zanthiu* është përdorur me funksion afekti dhe mllëfi të dashnorit për mosrealizimin e dashurisë duke i përbuzur mësitët hilexhi apo të paaftë:

*Shum-e mot hupa pas teje,
Shum-o mot e shum-e ditë,
Tye t'i çue do zanthiu msitë.
— Pse po i çon, djalë, msit' budallë?
Dama ditën kur me ardhë.*³⁰

Do të thotë, sipas këtyre vargjeve, se me gjithë pengesat dhe sakrificat, dashuria e sinqertë mund të realizohet drejtpërsëdrejti, pa ndërmjetësinë e shkuesve, ndaj me kompozitën *zanthiu* përbuzen dhe nënçmohen këta njerëz që përpiqen të nxjerrin levërdi materiale.

Se dashuria e përshkruar deri më tani në shembujt e zënë në gojë, lind e zhvillohet në një ambient blegtoral e bujqësor, tregojnë bindshëm edhe kompozitat që emërtojnë emrat e bagëtive dhe të bimëve e luleve, si *Galbalosha*, *lulebardha*, etj. që i ndeshim në vargjet e lirikës së dashurisë, duke pikturuar mjedisin tipik fshatarak, ato na paraqesin tabllo nga kjo jetë bukolike:

*Gal-baloshën me cingare*³¹
„Nën një mollë e nën një dardhë,

ose

*Nën një kumull lulebardhë,
Herr e korrë syzeza n'arë.*³²

Mirëpo ndër të gjitha këngët nga të cilat volëm vargje për të vënë në pah funksionin artistik të kompozitave, në tërë blenin dallohet për përdorimin e dendur kontekstual të kompozitave të përdorura me shije të hollë gjuhësore e artistike kënga „Rreth e rreth jatij ftue”, ku kompozitat janë përdorur në çdo të dytin varg, duke e fuqizuar e lartësuar vlerën artistike të poezisë në fjalë, prandaj për të dëshmuar këtë pohim po sjellim vargjet vijuese:

²⁹ *Po aty*, f. 45.

³⁰ *Po aty*, f. 29.

³¹ *Po aty*, f. 323.

³² *Po aty*, f. 161.

*Rreth e rreth-o jasaj mollë
Kur e ke-o jat kryqhollën;
Kur e ke-o jat kryqhollën-o,
Edhe e han si mollën-o.*

*Kur e ke-o krahgjanën-o,
Edhe e han si manën-o.
Kur e ke-o syzezën-o,
Edhe e han si shegën-o.
Kur e ke-o qafbardhanën-o,
Edhe e han si dardhën-o.³³*

Pra, siç shihet nga shembujt e mësipërm, kompozitat e përdorura me veçanti gjuhësore në këngët e dashurisë, shtojnë shijen e përdorimit të tyre në ligjërimet e rëndomta dhe në shkrimet tona, duke u bërë pronë e mbarë kulturës sonë gjuhësore.

Në krijimtarinë tonë popullore ndeshim në formime të bukura kompozitore, siç i kemi vënë në spikamë këto që i dhamë edhe në vargje: *bojgjake, shamikuqe, shamiverdhë, syzezë, zylyfzezë, zylyfshkurta, vetullgale, vetullhollë, vetullgjylpanë, vetullkaleme, faqekuqe, faqeshkurta, faqebardha, gojëmjalta, gojëbuta, gojëshiqere, musteqezi, mjekërrzi, mjekërrbutë, qafëbardhanë, qafëgastare, ballagushe, krahdalldyshë, krahgjanë, përmjet-hollë, belhollë, mjedishollë, kryqhollë, vithegjanë, mollkuqe, kryeungjur, jetimzeza, Galbalosha, lulebardha, etj. të cilat përdoren mjaft dendur në blenin e Këngëve të dashurisë I, prej të cilit i nxorëm këta shembuj të nduarduart të këtij lloj fjalëformimi, ndaj mund të themi se „kompozitat e shqipes i hapin studiuesit të gjuhës sonë një shesh të gjerë studimi pse janë shumë e gjithfarësh”.³⁴ Prandaj nga ky punim mund të konstatojmë se pasuria folklorike e një populli nuk është objekt studimi vetëm i folkloristëve, por edhe i gjuhëtarëve.*

Meqenëse nga shembujt e deritanishëm, dëshmohet bindshëm se krijimtaria jonë gojore është kultivuese e kompozitave, përkundra mendimit të albanologëve të huaj se shqipja është e varfër me kompozita, nga njëra anë, e duke dyshuar se folkloristët e mirëfilltë zor se do ta bënë këtë punë, nga ana tjetër, atëherë ne u përpoqëm që të vëmë në spikamë jo vetëm pasurinë dhe llojshmërinë e madhe të kompozitave të folmeve tona dialektore, por edhe të dëshmojmë për funksionin e tyre artistik dhe shijen e hollë estetikë që shprehin ato në vargjet e lirikës sonë popullore.

Një studim më i gjerë dhe më i hollësishëm do të na ofronte një pasqyrë shumë më reale e akoma më të larmishme e do të dëshmonte për pasurinë e krijimtarisë popullore me kompozita në tërësi, vjetërsia dhe karakteri i mirëfilltë i tyre tregon për një thesar të pasur të leksikut të folklorit tonë.

³³ Po aty, f. 177.

³⁴ Aleksandër Xhuvani, *Kompozitat, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972, f. 72.

Mehmet Halimi

FUNCTION ARTISTIQUE DES COMPOSÉS DE MOTS DANS LES VERS
DES CHANTS D'AMOUR

Résumé

Cet exposé traite des composés de mots et dans les vers lyriques populaires. Dans ce but nous avons observé les composés de mots du recueil Këngë dashurie I /Les chants d'amour I/ publié par l'Institut albanologique de Prishtina.

Les composés de mots populaires sont une source intarissable d'enrichissement de la langue écrite. Ils offrent de grandes possibilités pour exprimer des nuances sémantiques très subtiles et un sens linguistique affiné.

Dans notre création orale nous rencontrons la formation de composés particulièrement adaptés comme nous l'avons montré dans notre travail à l'aide des exemples relevés dans le recueil étudié. Nous pouvons distinguer les composés que l'on emploie davantage: bojgjake, shamikuqe, shamiverdhë, syzezë, zylyfzezë, zylyfshkurt, vetullgalë, vetullhollë, vetullgjylpanë, vetullkaleme, faqekuqe, faqeshkurtna, faqebardha, gojëmjalta, gojebuta, gojëshiqere, përmjethollë, belhollë, mjedis-hollë, kryqhollë, vithegjanë, jetimzeza etc.

Ces composés prennent vie dans la langue et artistiquement en mettant en valeur le goût délicat du peuple albanais pour la beauté de la femme, ainsi par exemple les vers suivants: „Moj syzezë, vetullgjylpanë / O ma belle aux yeux noirs, aux sourcils fins comme des aiguilles, Lum' yt at / heureux ton père, / lumja jot'amë / heureuse ta mère, / Ma lum çuni qi t'ka zanë / heureux le garçon qui t'a pris ou bien: / „Del zyzeza n'derë t'oborrit / zylyfzezë / touffes de cheveux coupés court qui pendent des deux côtés du visage / si krahi korbit etc.; / apparaît ma belle aux yeux noirs sur le seuil de la porte, sors dans la cour mabelle aux touffes de cheveux semblable dux ailes du corbeau.

Comme on le voit d'après les exemples ci-dessus, les composés utilisés avec leur particularité linguistique dans les vers lyriques populaires, pénètrent dans le langage ordinaire et augmentent le fond de notre culture linguistique.

Contrairement à l'opinion de certains albanologues étrangers considérant l'albanais comme pauvre en composés notre création orale populaire témoigne de la richesse de la formation des composés de mots.